



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.37, datë 26.06. 2007

**“PER KALIMIN KAPITAL TË OBJEKTIT PALESTRA E ESTRADËS TIRANË,
BASHKISË TIRANË”**

Mbështetur në Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000, “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma ç, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.6, datë 21.03.2005, “Për riorganizimin e Teatrit të Cirkut, Teatrit të Estradës, Qendrës Rekreative “Tirana” në Qendrën Kulturore “Tirana” dhe nivelin e pagave të punonjësve“, V.K.M. Nr. 153, datë 03.04.1999 ”Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, pika 2, gërma ç, Ligjit Nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Kalimin kapital të Palestrës së Estradës Tiranë pranë aparatit të Bashkisë së Tiranës, me qëllim kryerjen e funksioneve të saj, me këto dhëna:
 - Vlera e objektit 110.000 lekë
 - Sipërfaqja e objektit 120 m²
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të kryhen veprimet kontabël pranë Qendrës Kulturore “Tirana” dhe Bashkisë Tiranë.
3. Hartimi i gen-planeve të reja të veçantë për Qendrën Kulturore “Tirana” dhe Bashkinë e Tiranës, duke kryer veprimet me objektin dhe truallin sipas pikës 1 të këtij Vendimi, me pakësim për Qendrën Kulturore “Tirana” dhe shtim Bashkisë së Tiranës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra Kulturore “Tirana”, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Administrimit të Aseteve dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik të Qytetit.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SOKOL DERVISHAJ

K R Y E T A R

